

REPREZANTIMI I DHUNËS NË MEDIA (PORTALE) NDAJ GRAVE

GJATË VITEVE 2020-2021

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

ADELA BAJRAMI IBRAHIMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

KORRIK, 2021

Reprezantimi i dhunës në media (portale) ndaj grave gjatë viteve 2020-2021

Adela Bajrami Ibrahim

Mentori/ja: Kaltrina Kelmendi, Prof. Ass. Dr.

Dhuna ndaj grave është një fenomen i përhapur në të gjithë botën dhe njihet si një nga sfidat më serioze për shëndetin dhe përfshirjen sociale të grave dhe vajzave (Devries, K.M., et al., 2013). Në shoqëritë demokratike, mediat marrin një rol drejtues, kontrollues dhe orientues. Paraqitjet mediatike të dhunës janë një element i rëndësishëm në mënyrën se si publiku i kupton ato çështje (Comas-d'Argemir, 2015). Pra media jo vetëm që pasqyron atë që po ndodh në shoqërinë tonë por gjithashtu përforcon stereotipet se si shihen gratë.

Duke parë gjithnjë e më shumë përhapjen e këtij fenomeni dhe mungesën e hulumtimeve të tilla në kontekstin e Kosovës, qëllimi i këtij hulumtimi është të eksplorojë se si reprezentohet dhuna në media ndaj grave gjatë viteve 2020-2021 dhe ti ofrojë mediave mundësinë për të punuar në parandalimin e saj. Prandaj ky studim do ti përgjigjet pyetjes kërkimore e cila është: Si reprezentohet dhuna në media ndaj grave?

Për të realizuar këtë hulumtim fillimisht janë zgjedhur tre portale të Kosovës të cilat kanë reprezentuar lajmet e dhunës ndaj grave gjatë viteve 2020-2021. Këto portale janë: Kallxo.com, Koha.net dhe Indeks Online. Për secilin nga portalet janë marrë lajmet nga një periudhë kohore prej 6 muajsh. Kallxo.com ka përfshirë lajmet Janar – Qërshor 2020; Koha.net ka përfshirë lajmet Korrik – Dhjetor 2020; dhe Indeks Online ka përfshirë lajmet Janar – Qërshor 2021. Arsyeya e kësaj ndarje ka qenë shmangia e përsëritjes së lajmeve të njejta.

Ky hulumtim është i dizajnit kualitativ, ku është përdorur analiza e përmbajtjes (Content Analysis) e cila është një mjet kërkimor që përdoret për të përcaktuar praninë e fjalëve, temave ose koncepteve të caktuara brenda disa të dhënave cilësore. Konkretisht kjo analizë është marrë me përmbajtjen e temave të dhunës në portale. Pas mbledhjes së 462 lajmeve, janë koduar 2740 kode, të cilat janë gjeneruar në 24 kategori tematike dhe 7 tema kryesore.

Rezultatet tregojnë se gjatë viteve 2020-2021 në periudhën e pandemisë Covid-19, dhuna ndaj grave është dyfishuar. Ajo ka qenë e të gjitha formave duke përfshirë dhunën fizike, psikike, seksuale, emocionale dhe ekonomike. Gjithashtu kanosjet, trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni dhe tentativat për vrasje kanë qenë prezente gjatë këtyre viteve. Lajmet gjithashtu tregojnë se pasojat e kësaj dhune kanë qenë nga më të lehtat deri tek ato më të rëndat, dhe se një numër i madh i viktimave kanë pranuar tretman mjekësor pas dhunës së ushtruar mbi ta. Në përgjithësi lajmet më shumë janë të reprezentuara në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk japin detaje të tilla se cilat janë arsyet pse ka ndodhur dhuna. Megjithatë disa nga shkaqet e paraqitura kanë qenë: mosmarrëveshjet, të qenit nën ndikimin e alkoholit, problemet psikike që kanë pasur ushtruesit e dhunës dhe situata me pandeminë Covid-19.

Duke e vlerësuar rolin e medias si “formues” dhe jo vetëm “informues”, roli dhe kontributi që jep dhe mund të vazhdojë të japë media në parandalimin e dhunës është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm. Media ka fuqinë e mesazhit të fuqishëm. Ky mesazh duke lënë gjurmë, rrit në përgjithësi ndërgjegjësimin e shoqërisë për faktin se dhuna është një dukuri që vetëm dëmton dhe nuk i bën mirë askujt, por nga ana tjetër edhe informon se ndaj saj ka mjete ligjore që i japin mbështetje me forcën e ligjit të dëmtuarve nga kjo dukuri.